



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM Nr 183 Datë 26.12.2019

“ Përjashtim nga tarifatat mujore të pagesave për Kopsht të fëmijëve në nevojë”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe kërkesave të ardhura pranë Sektorit të Arsimit, kërkojmë në Këshillin Bashkiak miratimin për heqjen e tarifës mujore të pagesës Këshilli Bashkiak Dibër I mbledhur me datë 26.12.2019 me 20 vota pro:

VENDOSI :

1. Miratim të heqjes së tarifës mujore të pagesës ditore prej 120 lekë të reja që përbën në total rreth 2600 lekë të reja në muaj
2. Familjet e ketyre fëmijëve janë në kushte të vështira ekonomike dhe pagesa ditore prej 120 lekë të reja që përbën në total rreth 2600 lekë të reja në muaj është e papërballueshme për ta.
3. Të parashikohen në buxhet dhe me preventiv emrat e fëmijeve të cituar në këtë vendim për të përfituar shërbimet në kopshte dhe çerdhe

- | | |
|-----------------------------------|-----------------|
| 1. Elisabeta Altin Përhati | Peshkopi |
| 2. Hysni Altin Përhati | Peshkopi |
| 3. Omar Denis Osmani | Peshkopi |
| 4. Rufana Sulltan Cena | Peshkopi |
| 5. Uendi Ndriçim Jashari | Peshkopi |

Elisabeta Përhati dhe Hysni Përhati janë motër e vëlla në kushte ekstreme, dy prindër të papunë. Familja trajtohet me Ndhmë Ekonomike në masën 4860 lekë në muaj.

Omar Osmani është fëmijë me prindër të divorcuar ku nëna e ka braktisur totalisht fëmijën. Këtë e vërteton Vendimi i Gjykatës me nr. 214, datë 23.05.2019. Familja trajtohet me Ndhmë Ekonomike në masën 1800 lekë në muaj nga bllok-fondi i 6%

Rufana Cena vjen nga një familje ku i ati është i paafte për të punuar dhe trajtohet me pension invaliditeti në masën 10.000 lekë të reja në muaj.

Uendi Jashari i përket një familjeje në kushte të vështira, dy prindër të papunë dhe me shtëpi me qera. Familja trajtohet me Ndhmë Ekonomike në masën 4860 lekë në muaj.

Për të shmangur mosfrekuentimin e pesë fëmijëve të mitur për të marrë bazat mësimore të arsimit parashkollor si dhe gjithëpërfshirjen me bashkëmoshatarët e tyre në ambjentet e kopshtit, kuota prej 2600 lekë të reja, për secilin prej tyre, me propozim nga Sektori i Arsimit Kulturës dhe Turizmit, paraqitet për.

4. Me zbatimin e këtij vendimi do të merret Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës)pranë Bashkisë Dibër. dhe Sektori i Arsim Kulturës pranë Bashkisë Dibër.

1. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit dhe konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Dibër.
2. U shpall sot me date 26.12.2019.

Sekretare Këshilli

Inva TRUPJA



Kryetar Këshilli

Sokol SAVA